**VENDIM**
**Nr.768, datë 14.11.2007**

# PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONËS NR.185 "BATALIONI I VËZHGIMIT AJROR" (ISH-REPARTI USHTARAK 3332) SAUK, TIRANË, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, shkronja "c" të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës dhe të Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronës me numër rendor 185 "Batalioni i vëzhgimit ajror" (ish-reparti ushtarak 3332) Sauk, Tiranë, sipas vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për sigurimin e mjediseve shtesë për veprimtarinë e institucioneve të arsimit të lartë.

2. Prona me numër rendor 185, "Batalioni i vëzhgimit ajror" (ish-reparti ushtarak 3332) Sauk, Tiranë, të hiqet nga lista e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave.

3. Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Sali Berisha**

## 3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
( Per inventarizimin e pronave si klasa te vecanta )

| Komuna Farkë, Tiranë | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | A | | B | | | | C | | | |
| Nr | Zona Kadast Indeksi i hartes | Numeri pasuris | Emertesa e prones Vendodhja/ shtrirja Gjeografike | Komponentet perberes te prones | Adresa/ vendodhja e komponenteve perberes | Permasat e Prones ne M2.ose Ml | Funksioni per te cilin perdoret prona | Enti me Pergjegjesi Administrative | Enti Perdorues Statusi Juridik i perdorimit | Te dhena te tjera shenime te veçanta |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 185 | | | Repart Ushtarak Nr. 3020 | | | 24200 M2 | Per Mbrojtjen | MM Rep.Usht. 3400Tirane | Rep.Usht. 3020 Tirane | |
| | | | Sauk Tirane | Zyrat e komandes | Sauk Tirane | 275 | | | | |
| | | | | Trup roje | | 40 | | | | |
| | | | | Oficna | | 360 | | | | |
| | | | | Depo materjalesh | | 192 | | | | |
| | | | | Depo materjalesh | | 192 | | | | |
| | | | | Park 8 vendesh | | 216 | | | | |
| | | | | Depo municioni | | 91 | | | | |
| | | | | Depo materjalesh | | 40 | | | | |
| | | | | Depo menxe guzhine | | 68 | | | | |
| | | | | Zdrukthtaria | | 40 | | | | |
| | | | | Depo karburanti ½ n/toksore | | 50 | | | | |
| | | | | Wc | | 12 | | | | |
| | | | | Rruge te brendeshme | | 200 | | | | |
| | | | | Linje ujesjellesi | | 160 ml | | | | |
| | | | | Truall | | 22474 | | | | |

PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.1 KOMANDA KATI PERDHE
SHKALLA 1/100
SIPERFAQJA 211.4 m2




DR MYSUM PASHA

PLANIMETRIA E OBJEKTIT NR.1 KOMANDA KATIT TARE
SHKALLA 1/100
SIPERFAQJA 211.4 m2




| | | | |
|---|---|---|---|
| REP.SHQIPERISE MIN. MBROJTJES I.G.J.U. | DREJTORI | DR MYSLIM PASHA | |
| | VIZATOI | N/Tog A. BILI | |
| REP USHT.Nr 3332 SAUK | PERPILOI | Top S LLESHI | |
| | KONTROLLOI | Ing. K. HYSENI | |




SHKALLA 1:1000

PUNOI

MAJOR R. HAXHIU, S. LLESHI, D.HYSI

MAJOR ING ILIR ÇEKPEZI

DR. MYSLIM PASHA

DREJTORI I.G.J.U.